

## Hapet Spitali Qendror në QSUT



Hapet SPITALI QENDROR, vepra më e madhe e shëndetësisë në tre dekadat e fundit. Spitali Qendror ka një sipërfaqje ndërtimi 23,290 m<sup>2</sup>, me kapacitet 345 shtrretër ku akomodohen 14 shërbime mjekësore spitalore të specializuara nga kardiologjia, nefrologjia, hematologjia, gastrohepatologjia, mjekësia interne, endokrinologjia, dermatologjia, reumatologjia, alergologjia, urgjenca dhe imazheria, ku do të punojë një staf prej 612 mjekësh, infermierësh, teknikësh, koordinatorësh, punonjësish mbështetës. Me vizionin për modernizimin e qendrës më të madhe spitalore në vend, 5 vite më parë nisi zbatimin e masterplanit për QSUT. Pas përfundimit të veprave si Spitali Kirurgjikal "Frederik Shiroka", Spitalit të ri Pediatrik, Spitalit Infektiv, Depos Farmaceutike QSUT, vijon puna me intensitet për fazën e dytë të rindërtimit të Spitalit Pediatrik, e në vijim do të hapen investime të reja me projektet për rehabilitimin e Spitalit të Kardiokirurgjisë, Spitalit Psikiatrik dhe atij të Djegje-Plastikës në QSUT.



### SPITALI MEMORIAL FIER MERR KARTËN E AUTONOMISË MENAXHERIALE

Spitali Memorial Fier është spitali i parë publik që përfiton Kartën e Autonomisë Menaxheriale me afat dy vjeçar, pas përmbyshjes së të gjithë kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e Autonomisë Spitalore. Autonomia spitalore i jep mundësinë spitaleve publike të kenë mekanizmat e duhur ligjorë dhe rregullatorë për t'u vetë-administruar për nga pikëpamja menaxheriale dhe financiare; për rritjen e konkurrencës ndërmjet spitaleve publike ndërmjet njëri – tjetrit por dhe me spitalet jopublike, për rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor për qytetarët; mirëmenaxhimit të burimeve njerëzore dhe rritjen e instrumentave dhe mekanizmave për punësimin e mjekëve specialistë në sektorin publik.

### FISHAT E DIABETIT FALAS PËR PENSIONISTËT

Nis shpërndarja e fishave të diabetit me rimbursim për të moshuarit +65 vjeç. Nga ky vendim i qeverisë përfitojnë mbi 50 mijë pensionistë. Rimbursimi i fishave të diabetit nisi për grupmoshën 0-18 vjeç në 2018 dhe më pas u zgjerua edhe për të rinjtë deri 25 vjeç. Nga 27 shkurti 2023, fishat për matjen e glicemisë përfitohen në të gjitha farmacitë e rrjetit të hapur me kontrate me FSDKSH, edhe nga të moshuarit +65 vjeç. Pacientët me diabet përfitojnë trajtimin e plotë falas, me një financim të barnave me rimbursim në vlerën 2.2 miliard lekë/vit.



### PUNËSOHEN 324 INFIERMIERË DHE 66 MJEKË NË DY MUAJT E PARË TË 2023

Për periudhën janar-shkurt 2023 janë punësuar 324 teknikë të shkencave mjekësore dhe 66 mjekë në strukturat shëndetësore publike. Portalet "Mjekë për Shqipërinë" dhe "Infermierë për Shqipërinë" tashmë janë kthyer në instrumente, që garantojnë punësimin në bazë meritokracie dhe transparence, duke i mundësuar sistemit shëndetësor të rekrutojë profesionistët më të mirë.

### SHQIPËRIA NË SESIONIN E 67-TË TË KOMISIONIT PËR STATUSIN E GRUAS NË OKB

Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mori pjesë në Sesionin e 67-të të Komisionit për Statusin e Gruas, që zhvilloi punimet në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në Neë York, me përfaqësues të lartë të shteteve anëtare, organizatave të OKB dhe organizatave të ndryshme nga e gjithë bota, për të shkëmbyer eksperiencat për aksesin në shërbimet publike dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për nxitjen e barazisë gjinore. Sesioni i këtij viti i Komisionit për Statusin e Gruas (CS67) është fokusuar tek inovacioni, ndryshimet teknologjike, edukimi në epokën digjitale drejt arritjes së barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të grave dhe vajzave në shoqëri.



### KONGRESIN I PARË I SHËNDETËSISË

Kongresi i parë i Shëndetësisë u mbajt në datat 5, 6 dhe 7 Mars në Tiranë, me pjesëmarrjen e më shumë se 2000 pjesëmarrësve: politikëbërës, ekspertë vendas dhe të huaj, ofrues shërbimesh, profesionistë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, me qëllim ndërtimin e një platforme interaktive komunikimi. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale foli për vizionin e qeverisë shqiptare për transformimin e shëndetësisë, përmes investimeve në sektor, mbështetjen e profesionistëve të shëndetësisë dhe politikave të reja për mbështetjen e grupeve më në nevojë.